

# **E DREJTA PËR ANKESË**

**Udhëzues për të drejtën  
për t'u ankuar ndaj  
përmbajtjes mediale**

Nëntor 2015



## **Komisioni i Pavarur për Media**



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

**Si duhet bërë një ankesë te Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transmetimit apo përdorimin e brezit frekuencor të radios?**

## **Cili është funksioni i Komisionit të Pavarur për Media?**

I themeluar në vitin 2005, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës KPM përcaktohet organ i pavarur.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Përgjegjësi e KPM-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.

Politika e transmetimit e KPM-së është në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtare të transmetimit dhe të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-se e në veçanti me Direktivën e Komisionit Evropian (AVMS) duke respektuar plotësisht demokracinë, sundimin e ligjit, mbrojtjen e lirisë së shprehjes, dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audiovizuale.

Në bazë të ligjit, KPM ka mandatin të përgatisë Strategjinë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike për shërbimet mediale audiovizuale.

Adresa e Komisionit të Pavarur të Mediave është:

Rr. Perandori Justinian Nr. 14, Qyteza Pejton 10000, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 245-031 Fax: 038 245-034 e-mail: [info@kpm-ks.org](mailto:info@kpm-ks.org)

## **Çfarë është një ankesë?**

Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me shkelje të mundshme të kushteve të licencës për transmetim, Kodit të Sjelljes për Shërbime Mediale Audiovizuale, akteve nënligjore të KPM-së. Çështjet më të rëndomta të ankesës janë drejtësia apo saktësia e një programi të transmetuar apo interferencat e sinjalit transmetues të një subjekti transmetues me tjetrin.

Procedimi i ankesave të tilla nuk duhet të ngatërrohet me censurimin. KPM-ja nuk mund t'i tregoi mediumit se çka ata duhet apo nuk duhet të transmetojnë. Rregulloret e KPM-së thjesht kërkojnë nga mediat Kosovare t'i përkrahin standardet evropiane të profesionalizmit. Kjo do të thotë se çështjet duhet të prezantohen nga të gjitha anët, në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Mediat gjithashtu duhet të përmbahen nga transmetimi i materialit që mund të rrezikoj sigurinë e një individi, apo që përmban rrezik të madh të kërcënimit të rendit publike, siç mund të jetë nxitja e dhunës.

## **Kush mund të dorëzojë ankesë?**

Komisioni i Pavarur i Mediave monitoron transmetimet e shërbimeve mediale audio-vizuale Kosovare dhe mund të inicioj ankesën e vet ex-officio nëse beson që ndonjë nga rregulloret e saj është shkelur. Megjithatë, KPM kryesisht mbështetet te publiku i cili i tregon për problemet duke dorëzuar ankesa. Çdo person apo organizatë në Kosovë mund të parashtror një ankesë. Pasi që ankesa të jetë parashtruar zyrtarisht, procedura ligjore është e njëjtë pavarësisht nëse është parashtruar nga një qytetar apo ex-officio.

## **Në lidhje me çfarë ju mund të parashtroni një ankesë?**

KPM-ja mund të shqyrtojë një ankesë nëse është transmetuar një lajm, kronikë, emision, shpallje apo përmbajtje:

E njëanshme dhe e padrejtë

E pasaktë ose mashtruese

Fyese ose e dëmshme

Shkelje e privatësisë

Mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve dhe të miturve

Nxit urrejtje racore, fetare apo kombëtare.

### **Para se ta parashtroni një ankesë**

Nëse keni ndonjë shqetësim për sjelljen e mediave, së pari provoni ta kontaktoni mediumin relevant. Mënyra më e mirë është ta telefononi atë së pari, pastaj t'i shkruani atyre një letër. Në këtë mënyrë shumë ankesa mund të zgjidhen pa përfshirë KPM-në.

Së pari kërkoni nga mediumi të lëshoj korrigjimin e vet apo sqarimin e të dhënave. Nëse çështja ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në reputacionin tuaj, ju mund të ushtroni të Drejtën Tuaj për Reagim dhe të kërkoni që në mënyrë të drejtpërdrejt t'i përgjigjeni vet programit të transmetuar.

Sqarimi duhet të jetë i thjeshtë, faktik dhe i shkurtër.

Jepni mediumit një periudhë të arsyeshme kohore për të rishqyrtuar ankesën dhe/apo kërkesën tuaj. Nëse mediumi nuk pajtohet për një zgjidhje adekuate në një periudhë të arsyeshme kohore (siç është 48 orë), informoni mediumin që ju do të parashtroni një ankesë në KPM.

Nëse përsëri nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e mediumit, ju lutemi shkruani, dërgoni me faks apo e-mail ankesën tuaj tek KPM-ja, së bashku me dokumentacionin për shkelje, nëse është e mundshme. (Informatat tona kontaktuese janë të regjistruara në kolonën e djathtë të kësaj faqeje).

### **Si të parashtroni një ankesë**

Kontakto KPM-në përmes telefonit, faks-it, e-mailit, apo na vizitoni personalisht. Ju duhet të na jepni informatat vijuese:

- Emrin e mediumit.
- Datën dhe kohën e transmetimit të programit për të cilin ka të bëjë ankesa.
- Deklaratë të qartë dhe specifike për shkeljet që ju besoni se u janë bërë.

Kini parasysh që procesi i ankesave të KPM-së nuk është i përgatitur të merret me komentimet apo deklaratat me të cilat ju thjeshtë nuk pajtoheni. Qëllimi i KPM-së është të zgjidhim çështjet e drejtësisë, me argumente dhe përmes saktësisë.

### **Paraqitni një ankesë sa më shpejt**

Rregulloret e KPM-së kërkojnë nga subjektet transmetuese të mbajnë incizimet e të gjitha programeve të tyre për 21 ditë, përveç nëse kërkohet ndryshe nga KPM-ja. Është me rëndësi që ankesa juaj të mbërrij tek ne me kohë në mënyrë që ne të procedojmë atë para se të kalojnë 21 ditë nga koha kur ju i referoheni ndonjë programi transmetues. Nëse arrin shumë vonë, dokumentacioni mund të jetë hequr nga arkiva dhe procedimi i rastit për të zgjidhur ankesën do të jetë më i vështirë.

### **Çfarë do të bëj KPM-ja me një ankesë?**

Së pari, KPM-ja do ta regjistrojë dhe shqyrtoj ankesën nëse është e kompletuar. KPM-ja do të kontaktoj mediumin për ta diskutuar ankesën dhe gjithashtu mund t'ju kontaktoj juve për informata tjera. KPM-ja do të kërkoj nga stacioni materialet relevante nga arkiva.

Nëse subjekti transmetues nuk mban një arkiv, do të jetë vështirë të procedohet ankesa, por KPM-ja mund të vendos sanksione edhe vetëm për mungesë të arkivës.

Porsa të mblidhen dëshmitë paraprake, Divizioni Ligjor i KPM-së do të shqyrtoj ankesën për të caktuar nëse Ligji i KPM-së apo ndonjë prej rregulloreve të saj është shkelur dhe do t'i bëjë rekomandime Këshillit të

KPM-së. Nëse KPM-ja konkludon që një rregullore është shkelur, ajo së pari do të përpiqet të gjejë një zgjidhje apo marrëveshje jashtë-gjyqësore që kënaqin të dyja palët, mediumin dhe personin apo organizatën që ka parashtruar ankesën pa nevojën për sanksione formale. Zgjidhjet e mundshme përfshijnë:

- Një sqarim apo korrigjim nga mediumi
- E Drejta për Kundërpërgjigje dhënë për qytetarin që ankohet
- Kërkim faljeje publike prej mediumit

Nëse nuk mund të gjendet një zgjidhje e përshtatshme, Këshilli i KPM-së do t'ia lëshoj mediumit një njoftim zyrtar për shkelje, duke theksuar shkeljet për të cilat akuzohet dhe duke shpjeguar që KPM-ja mund të vendos sanksione për të dënuar shkeljen. Pasi që njoftimi për shkelje të lëshohet, mediumi ka shtatë ditë për tu përgjigjur. Nëse përgjigjja është e pakënaqshme, KPM-ja ose do të lëshoj një paralajmërim formal për mediumin ose do të inicioj procedura ligjore për të zbatuar sanksionet. Përveç nëse është shumë serioze, për shkelje të parë mediumi zakonisht merr një paralajmërim. KPM-ja mund të sanksionojë subjektet transmetuese nëse është dëshmuar se subjektet transmetuese kanë bërë ndonjë shkelje.

### **Bordi i KPM-së për Ankesa**

Në përputhje me ligjin nr. 04 / L-44 të KPM-së, anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave transparente. Bordit për Ankesa përbëhet nga tre anëtarë dhe është i pavarur si në kryerjen e funksioneve të tyre dhe në vendimmarrje. Në bazë të nenit 42 të ligjit nr. 04 / L-44 rregullat dhe procedurat e Bordit të Ankesave janë të disponueshme për publikun.

Në përputhje me Nenin 43 të ligjit nr. 04 / L-44, ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me



dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji.

Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

### **Vendimet e Bordit të Ankesave**

për Ankesa, lidhur me ankesat e parashtruara nga mediat, nxjerr vendimin përfundimtar me shkrim. Ky vendim u dorëzohet palëve dhe publikohet nëpërmjet Zyrës së Kryeshefit.

Vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi.

### **KPM i jep përparësi marrëveshjeve dhe zgjidhjeve konstruktive**

Në përgjithësi, KPM-ja kërkon, përmes negociatave dhe marrëveshjeve jo-procedurale të shmangë procedurat që kërkojnë kohë për t'i zgjidhur ankesat. Po ashtu, KPM-ja preferon zgjidhje konstruktive në lidhje me gjobat. Në çdo kohë, gjatë hetimit të një ankese formale, KPM-ja është e hapur për të folur për mundësinë e një marrëveshjeje.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



## FORMULAR PËR ANKESË

**Për: KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE**

**Nga:**

**Tema:**

**Data:**

---

---

---

---

---

### \*PËRSHKRIMI I DOKUMENTIT

Emri i mediumit.

Datën dhe kohën e transmetimit të programit për të cilin ka të bëjë ankesa.

Deklaratë të qartë dhe specifike për shkeljet që ju besoni se u janë bërë

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Nr. kontaktues \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

## KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština- Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+381) (0) 38 245 031, Fax: (+381) (0) 38 245 034, E-mail: [Info@kpm-ks.org](mailto:Info@kpm-ks.org); [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org);



**KKPM-2013/07**

Në mbështetje të Nenit 3.2.6 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligjit për KPM-në), KPM nxjerr:

## **KODI I SJELLJES PËR SHËRBIMET MEDIALE AUDIO – VIZUELE**

### **NENI 1 QËLLIMI**

Kodi i sjelljes ka për qëllim përcaktimin e rregullave të sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit territorial dhe të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave dhe të krimit; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për mbrojtjen e prestigjit dhe të drejtave të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanësisë së drejtësisë.

### **NENI 2 FUSHËVEPRIMI**

1. Veprimtaria e shërbimeve mediale audiovizuale nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

2. Të gjitha shërbimet mediale audiovizuale të licencuara nga KPM, pavarësisht mënyrës së transmetimit, duhet t'i përmbahen dispozitave të këtij Kodi.
3. Shërbimet mediale audiovizuale do të respektojnë parimin e informimit të lirë dhe do të sigurojnë informata të sakta, me kohë, të vërteta, të qëndrueshme, të plota, të balancuara dhe të paanshme.
4. Shërbimet mediale audiovizuale përmes transmetimit të programeve të tyre nuk do të inkurajojnë apo nxisin, qëllimisht ose tërthorazi, asnjërin prej formave të diskriminimit dhe jo tolerancës.
5. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë asnjë material që njollosë një grup etnik ose fetar, ose që lë të kuptohet se një grup etnik apo fetar është përgjegjës për aktivitet kriminal.
6. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë asnjë material që nxitë apo inkurajon krimin ose aktivitete kriminale, ose që përmban në vete rrezikun e shaktimit të dëmit, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo ndonjë formë tjetër e dhunës.
7. Veprimtaria e shërbimeve mediale audiovizuale respekton paanshmërisht të drejtën për informim, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut si dhe të drejtat e liritë themelore të tij.

### **NENI 3 PËRKUFIZIMET**

1. **Shërbimi medial audiovizuel** – shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të

informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.

2. **Ofrues i shërbimit medial** - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
3. **Program** - një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosur nga ofruesi i shërbimit medial forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
4. **Përgjegjësia redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit televiziv, ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizuel në bazë të kërkesës.

#### **NENI 4**

#### **DALLIMI NDËRMJET LAJMIT DHE OPINIONIT**

1. Derisa janë të lirë t'i shprehin mendimet e veta, shërbimet mediale audiovizuale janë të obliguara që të bëjnë dallim të qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit.
2. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionit bart mendime, ide, besime, supozime, komente apo gjykime vlerësuese nga ana e shërbimeve mediale audiovizuale.

## **NENI 5**

### **VERIFIKIMI I FAKTEVE DHE RAPORTIMI I TË VËRTETËS**

1. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë material derisa nuk e bëjnë kërkimin rutinor dhe të arsyeshëm për të siguruar saktësinë, vërtetësinë dhe qëndrueshmërinë e tij.
2. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë material të pavërtetë apo mashtrues.
3. Shërbimet mediale audiovizuale kanë obligim profesional që me kohë të korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar për të cilin vërtetohet të jetë i pasaktë.
4. Shërbimet mediale audiovizuale nuk duhet të bëjnë plagjiaturë dhe duhet të theksojnë burimin e informatës që është publikuar diku tjetër.

## **NENI 6**

### **RAPORTIMI I DREJTË DHE I PAANSHËM**

1. Shërbimet mediale audiovizuale do të sigurojnë korrektësi, drejtësi dhe paanshmëri në të gjitha raportimet.
2. Shërbimet mediale audiovizuale do të sigurojnë prezantimin e këndvështrimeve të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Nëse njëra palë refuzon të ofrojë këndvështrimin e vet, publikuesi gjatë raportimit duhet ta theksojë këtë fakt.
3. Shërbimet mediale audiovizuale duhet të mbështeten në burime të identifikueshme të informacioneve dhe obligohen të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse kjo është kërkuar paraprakisht apo jo.
4. Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kontroverse, duke iu shmangur supozimeve, shërbimet mediale audiovizuale paraprakisht

do t'i kontrollojnë faktet si dhe do të marrin deklarata dhe komente nga të gjitha palët e përfshira në këtë ngjarje. Nëse ndonjëra palë refuzon të deklarohet, ky refuzim duhet të theksohet gjatë raportimit.

5. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do t'i favorizojnë interesat e një partie politike ose të një pikëpamjeje politike, as nuk do të jenë pjesëmarrës të një praktike që mund të ketë efekt të promovimit të një partie politike, një këndvështrimi politik, ndonjë grupi ose individ, që i përjashtojnë partitë, pikëpamjet, grupet tjera ose individët tjerë.

## **NENI 7**

### **TË DREJTAT INDIVIDUALE**

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare. E drejta për privatësi e individëve duhet të respektohet. Është e ndaluar ndërhyrja në çështjet thjesht private apo personale të cilat nuk kanë asnjë ndikim në interesin publik.
2. Personat e prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi, ata duhet të lejohen të vuajnë zinë e tyre në privatësi të plotë.
3. Asnjë material i transmetuar nuk duhet të shkelë, cenojë apo të ndërhyjë në të drejtën e individit që konsiderohet i pafajshëm derisa të shpallet fajtor nga gjykata kompetente.
4. Kujdesi dhe gjykimi i shëndoshë duhet të ushtrohet në zbulimin e identitetit të personave, me fytyrë apo emër, në mënyrë që të mos dëmtojë reputacionin, sigurinë e tyre apo të familjeve të tyre. Në çdo rast është i nevojshëm të jepet shpjegimi i qartë ndaj një personi të identifikuar si “i dyshuar”, “autor i dyshuar”, “ i akuzuar”, apo “i dënuar”.
5. Është i ndaluar transmetimi i materialit që tregon personat e arrestuar apo ndaluar që sulmohen fizikisht apo verbalisht në mënyrë që i përul apo poshtëron ata.

6. Asnjë person i identifikuar në transmetim i përfshirë në mbulimin e arrestimit, apo ndalimit të personave, nuk duhet të inkurajojë apo nxis kryerjen e dhunës kundër personit të arrestuar apo të paraburgosur.
7. Bisedat, thirrjet telefonike apo intervistat nuk duhet të transmetohen pa e informuar palën tjetër paraprakisht, përveç kur është në pyetje interesi publik.

## **NENI 8 SULMET PERSONALE**

1. Sulmet personale, duke përfshirë por jo kufizuar vetëm në sulmet në ndershmerinë, integritetin apo cilësinë personale të një personi, institucioni apo grupi të identifikuar, në çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin publik janë të ndaluara.
2. Ndalohen programet që kanë qëllim të keq, kriticizëm të padrejtë apo sulm në një person fizik apo juridik.
3. Kur transmetohen sulme personale ndaj ndonjë personi, institucioni apo grupi, atij personi, institucioni apo grupi duhet t'i jepet një mundësi e drejtë për t'u përgjigjur menjëherë në programin e njëjtë, nëse është e mundur, apo në rastin e parë të mundshëm dhe në kushte të ngjashme.

## **NENI 9 PRIVATËSIA**

1. Ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale nuk ju lejohe të japin emrat, përshkrimin, pamjet, ngjashmëritë ose informatat specifike të ndonjë individi që gjoja ka kryer një krim, deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata kompetente.



2. Rrëfimet mbi tragjeditë personale duhet të paraqiten me kujdes, duke pasur qasje mirëkuptimi dhe diskrete nga ana e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale.

## **NENI 10 DISKRIMINIMI**

Raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose të tjera, prejardhja kombëtare a shoqërore, lidhja me ndonjë komunitet, prona, gjendja ekonomike, sociale, orientimi seksual, lindjes, aftësia e kufizuar ose ndonjë status tjetër personal nuk do të shfrytëzohen në atë mënyrë që individët mund t'i vë në pozitë të pa lakmueshme, denigruese, me përqeshje apo tallje.

## **NENI 11 PREZANTIMI I FËMIJËVE DHE TË MITURVE**

1. E drejta e privatësisë së fëmijëve duhet të respektohet gjithmonë. Pasi që publiciteti i panevojshëm apo etiketimi i gabuar mund t'i dëmtojë ata, fëmijët që janë viktime të abuzimit apo në konflikt me ligjin nuk duhet të identifikohen, drejtpërdrejt apo indirekt. Nuk duhet të transmetohet asnjë informacion që mund t'i identifikojë ata. Befasitë apo intervistat e paplanifikuara (“pritat”) të fëmijëve janë të ndaluara.
2. Fëmijët viktime, të dyshuar, të akuzuar për një krim, të arrestuar apo ndaluar për dyshim të keqbërjes, dhe fëmijët që janë duke kaluar në proces gjyqësor duhet të mbrohen nga vuajtjet tjera të shqetësimit apo traumës; ata duhet të intervistohen vetëm me miratim të prindërve të tyre apo kujdestarit ligjor, përveç nëse prindi apo kujdestari është i akuzuar. Intervista duhet të bëhet vetëm me autoritet dhe mbikëqyrje të avokatëve, psikologëve apo punëtorëve social të kualifikuar përgjegjës për mirëqenien e tyre.

3. Fëmijët nuk do të detyrohen t'i rikujtojnë apo evokojnë përvojat traumatike, të demonstrojnë aktet e tmerrshme apo t'i përshkruajnë ato në detaje grafike.
4. Programet dhe materialet në të cilat janë të përfshirë fëmijët duhet t'i përmbahen Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre.
5. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë intervista apo pamje të fëmijëve nën moshën 14-vjeçare, të cilat dëmtojnë integritetin e tyre dhe familjeve të tyre, pa pëlqimin e prindit apo të ndonjë të rrituri i cili është përgjegjës për fëmijën.
6. Shërbimet mediale audiovizuale në asnjë mënyrë nuk do të identifikojnë fëmijët nën moshën 14-vjeçare të cilët janë të përzier në vepra penale, qoftë si dëshmitarë apo të pandehur.
7. Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.

## **NENI 12**

### **PËRDORIMI I GJUHËS**

1. Shërbimet mediale audiovizuale, gjatë transmetimit të përmbajtjeve programore, nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, religjioze, gjinore, racore, martesore, të moshës apo të paaftësisë fizike e mendore.
2. Shërbimet mediale audiovizuale nuk do të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtje dhe pabarazi dhe që mund të rezultojnë me veprime kriminale apo të dhunshme ndaj një individi apo grupi të caktuar.

3. Shërbimet mediale audiovizuele nuk do të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtje mbi baza të përkatësisë etnike, religjioze, gjinore, racore, martesore, të moshës apo të paaftësisë fizike e mendore, pavarësisht nga situata apo rrethana.
4. Referencat rreth përkatësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacione të tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejt për ngjarjen për të cilën raportohet.

### **NENI 13**

#### **NDALIMI I NXITJES SË DHUNËS**

1. Ndalohet përdorimi i gjuhës që tenton të nxis urrejtje, dhunë, kryengritje apo rebelim.
2. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele nuk do të transmetojnë asnjë material që me përmbajtjen e vetë vizuele apo me ton mund të:
  - 2.1 Paraqes rrezik të qartë për nxitje të dhunës, urrejtjes etnike apo fetare, çrregullim civil, trazira ose krim dhe aktivitete kriminale në mesin e qytetarëve të Kosovës.
  - 2.2 Paraqes rrezik të qartë për të shkaktuar dëm publik, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo dhunë tjetër.
  - 2.3 Detajet e një krimi apo përkrahimit të tij nuk duhet të paraqiten në atë mënyrë që do ta mësoj apo inkurajoj audiencën se si ta kryej atë.

## **NENI 14**

### **E DREJTA PËR REAGIM DHE KORRIGJIM**

1. Është obligim i shërbimeve mediale audiovizuale që të transmetojnë reagime dhe demante kur vërtetohet se kanë transmetuar informata të pasakta dhe të pavërteta për një individ apo organizatë.
2. Kur një gabim është transmetuar, ajo duhet të bëhet e ditur dhe të korrigohet sa më parë që është e mundur duke e theksuar gabimin dhe duke e bërë korrigjimin.
3. Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.

3.1 Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një shërbim medial audio-vizual për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun e të cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund të ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person.

3.2 Shërbimet mediale audiovizuale janë të obliguara që kërkesën për reagim ta shqyrtojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

## **NENI 15**

### **KONFLIKTI I INTERESIT**

1. Pronarët, menaxherët, kryeredaktorët dhe redaktorët përgjegjës, gazetarët dhe personeli tjetër që merret me sajimin dhe transmetimin e programeve në mediumet audiovizuale nuk do të pranojnë poste të tjera, mito apo dhurata të ndryshme të cilat shkaktojnë konflikte interesash me profesionin e tyre, komprometojnë kredibilitetin e tyre moral dhe profesional dhe që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre profesionale.

2. Kërkimi apo pranimi i parave apo ndonjë dhurate, përfitimi apo privilegji për të vënë në favor apo pozitë të keqe ndonjë person, grup, apo institucion gjatë transmetimit është e ndaluar. Çdo akt që mund të dëmtojë interesin publik, dëmtojë shërbimin medial audiovizuel apo të vë në dyshim kredibilitetin e tij në dyshim duhet të shmanget.

## **NENI 16 SANKSIONET**

Për shkelje të dispozitave të këtij Kodi, KPM do të ndërmerr masa sanksionuese të parapara me Ligjin e KPM-së.

## **NENI 17 HYRJA NË FUQI**

1. Ky Kod hyn në fuqi 8 dite pas nënshkrimit dhe është i obligueshëm për të gjitha shërbimet mediale audiovizuele të licencuara nga KPM.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij kodi, shfuqizohet Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audiovizuele në Republikën e Kosovës KKPM 2010/01.

## **Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**



**Si të parashtroni një ankesë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës?**

## **Cili është funksioni i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës?**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht, me kohë, dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë janë baza mbi të cilën vepron Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës.

KMSHK nuk ka për qëllim të zëvendësojë gjykatat e Kosovës, por, me gatishmërinë për t'u bërë një forum i besueshëm për gazetarët dhe lexuesit, një organ i paanshëm nga të cilat gazetarët fitojnë ide të reja dhe njohuri në fushën e etikës së gazetarisë.

## **Kush mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës?**

Ankesë mund të parashtrojë çdo person fizik ose juridik nga Kosova që gjithashtu mund të nis raste me vetiniciativë për hetimin e ankesave për shkelje të Kodit të Etikës.

## **Si të bëni një ankesë në Këshillin Mediave të Shkruara të Kosovës?**

Për të siguruar se artikulli i botuar në gazetë ose në faqen e internetit nuk përmban përmbajtje ofenduese, të dëmshme, të pasaktë ose të pandershme; ose përmbajtje e cila bën thirrje për urrejtje racore, fetare apo kombëtare, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, e ka hartuar një kod të sjelljes për gazetarë.

## **Çfarë duhet të bëni në rast se ju mendoni se disa gazeta apo portale e kanë shkelur kodin e sjelljes?**

Para paraqitjes së ankesës tuaj Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, është e nevojshme t'ia dërgoni një ankesë me shkrim direkt gazetës apo portalit që e ka botuar artikullin e diskutueshëm.

Në rast se ju nuk merrni përgjigje ose letra e juaj nuk publikohet në gazetë ose në portal, hapi tjetër është të parashtroni një ankesë / kërkesë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës.

### **Çfarë informatash është e rëndësishme t'i siguron kur të paraqitni një ankesë?**

Nëse e dorëzoni ankesën në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës si një individ (qytetar), është veçanërisht e rëndësishme që t'i ofroni informacionet e mëposhtme:

- Emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit me nënshkrimin tuaj;
- Emrin e gazetës apo portalit dhe artikullin për të cilin ankoheni;
- Data e botimit të artikullit për të cilin ankoheni;
- Titulli i artikullit;
- Arsyeja për ankesën me një shpjegim të shkurtër;

Personat juridik mund të paraqesin një ankesë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, me informacionin e mëposhtëm:

Emrin dhe adresën e personit juridik;

- Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor;
- Emri i gazetës / portalit për të cilin ankoheni;
- Titulli i artikullit;
- Data e publikimit të artikullit në të cilën ju jeni ankuar për;
- Një përshkrim i shkurtër i ankesës dhe nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor ose i personit të autorizuar për ankesë.

Vlen të përmendet se ankesa gjithmonë duhet të dorëzohet në procedurë me një nënshkrim personal.

### **Për çfarë mund të ankoheni?**

Këshilli i Mediave të Kosovës mund të konsiderojë ankesën nëse artikulli është i:



- njëanshëm dhe i padrejtë
- pasaktë ose mashtrues
- abuziv apo i dëmshëm
- kërcënon privatësinë
- Mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve dhe të miturve
- Inkurajon urrejtjen racore, fetare apo kombëtare.

Ankesat të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk do të merr në konsideratë janë:

- ankesat kundër gazetarëve / reporterëve
- ankesat për rregullimin dhe politikën redaktuese;
- mosmarrëveshjet midis gazetave dhe portaleve;

Cili është afati i fundit për parashtrimin e ankesës?

Për të hyrë ankesa e juaj në procedurë atë duhet ta dorëzoni brenda një muaji nga data në të cilën është publikuar artikulli i diskutueshëm.

### **Çfarë do të ndodhë me ankesën tuaj?**

- Ankesa juaj do të regjistrohet dhe ju do të merrni një numër të protokollit në të cilin ajo është regjistruar;
- Këshilli i Mediave të Kosovës do të hetojë ankesat e pranuar dhe të vendosë nëse ankesa është brenda juridiksionit të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës;
- Çdo vendim duhet t'i dërgohet menjëherë gazetës ose portalit në fjalë, brenda 3 ditëve të punës;
- Vendimet që janë bërë publike do të dërgohen në mediat e shkruara mbi një bazë jo-komerciale. Gazetat dhe portalet të përfaqësuara në Këshillit e Mediave të Shkruara të Kosovës do të publikojnë vendimet e Këshillit të Shtypit, pa pagesë dhe në vendin e duhur.

Bordi i Këshillit të Mediave mund të refuzojë ankesën. Në një rast të tillë, ankuesi do të informohet për arsyet e refuzimit të ankesës. Të gjitha vendimet e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të Këshillit.

### **Çfarë masash Këshilli i Mediave të Shkruara mund dhe nuk mund të merr?**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës do të shqyrtojë ankesën dhe çdo dëshmi të ankesave dhe do t'i kontaktojë gazetatat, portalet apo agjencitë e lajmeve kundër të cilave është bërë ankesa, për t'i informuar ata për ankesat e pranuar. Nëse ankesa nuk mund të zgjidhet ndryshe brenda një muaji nga data kur është hapur rasti, ankesa do të dorëzohet për shqyrtim nga Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, për shqyrtim të mëtejshëm dhe vendim. Përveç nëse ka arsye të veçanta për të kundërtën, vendimi përfundimtar lidhur me ankesën ose rastin e hapur do të arrihet brenda tre muajve nga hapja e rastit.

Është e rëndësishme të dini:

- a) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk është dhe nuk do të censurojë;
- b) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk mund të zëvendësojë gjykatat e Kosovës;
- c) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk do të imponojë përmbajtjen e gazetave, portaleve dhe agjencive të lajmeve apo të porosisë hapësirë në media për një grup të veçantë apo individ;
- d) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk shqyrton ankesat nga gazetarët apo reporterët;
- d) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk shqyrton ankesat për politikën redaktuese të gazetave, portaleve ose agjencive të lajmeve.

### **Rregullat e procedurës të Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**

1.

Këshilli i Mediave të Shkruara shqyrton ankesat e pranuar për shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe gjithashtu procedon rastet me iniciativë të vet. Ankesat mund të bëhen me shkrim, sipas procedurave të Sekretariatit. Ankesa parashtrohet, ose rasti për një ankesë hapet brenda një muaji nga data e publikimit të përmbajtjes kontestuese.

2.

Ankesat mund të bëhen nga kushdo. Ankesat anonime nuk shqyrtohen. Ankesat kundër gazetarëve individualë nuk pranohen. Ankesat pranohen vetëm nëse ato ngritën kundër medias përkatëse të shkruar, portalit apo agjencisë së lajmeve.

3.

Zyrtari i ankesave shqyrton të gjitha ankesat e pranuar dhe vendos nëse ankesa bie në kompetencat e Këshillit të Mediave të Shkruara.

4.

Nëse ankesa është në mënyrë të qartë jashtë kompetencave të Këshillit të Mediave të Shkruara, zyrtari i ankesave, pas diskutimit me drejtorin, e kundërshton ankesën dhe ankuesi informohet për arsyet e kundërshtimit të ankesës. Drejtori e informon Bordin e KMSHK-se për ankesat e refuzuara.

5.

Çdo ankese që është në kompetencën e Këshillit të Mediave të Shkruara, i jepet një numër reference dhe për atë ankesë hapet një dosje. Edhe ankesave të bëra me iniciativën e vet Këshillit të Mediave të Shkruara u jepet një numër reference dhe hapet një dosje për to.

6.

Media e shkruar, portali apo agjencia e lajmeve, kundër së cilës është paraqitur ankesë, ka mundësi që, brenda 15 ditëve, nga data e dorëzimit të ankesës në sekretarinë e Këshillit, të përgjigjet dhe komentojë çdo ankesë të bërë apo çdo rast të hapur në Këshillin e Mediave të Shkruara.

7.

Drejtori, së bashku me kryetarin e Bordit, ndërmarrin hapat në mënyrë që të pajtojnë palët e përfshira, përfshirë këtu inkurajimin e medias së shkruar, portalit apo agjencisë së lajmeve kundër së cilës është ngritur ankesa, që të garantojë të drejtën e përgjigjes ndaj ankuesit, nëse një gjë e tillë është e aplikueshme.

8.

Zyrtari i ankesave, kur e sheh të përshtatshme, së bashku me drejtorin, shqyrton të gjitha rastet, duke kërkuar ndonjë provë të nevojshme nga ankuesi dhe media e shkruar kundër së cilës është bërë ankesa, ose nga ndonjë burim tjetër. Rezultatet e një shqyrtimi të tillë, së bashku me çdo material të pranuar apo të mbledhur, futen në dosjen e rastit.

9.

Nëse çështja nuk zgjidhet brenda një muaji nga data e hapjes së rastit, kjo çështje i dorëzohet Bordit të Këshillit të Mediave të Shkruara. Për ankesën apo rastin e hapur merret një vendim përfundimtar brenda tre muajve, nga dita e hapjes së rastit, përveç nëse ka arsye të veçanta që të veprohet ndryshe.

10.

Zyrtari i ankesave paraqet rastet në Bordin e Këshillit të Mediave të Shkruara, duke shpalosur të gjitha dëshmitë e mbledhura, hulumtimet e bëra si dhe ndonjë përpjekje të bërë drejt pajtimit dhe rezultatit e arritur nga përpjekja e tillë. Pas rekomandimit të drejtorit, ankuesi dhe përfaqësuesit e medias, kundër së cilës është bërë ankesa, mund të thirren për seancë dëgjimore, nëse kështu vendoset nga Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara.

11.

Bordi i Këshillit të Mediave mund të refuzojë një ankesë. Nëse veprohet kështu ankuesi do të informohet për arsyet e refuzimit të ankesës.

12.

Këshilli i Mediave të Shkruara mund të urdhërojë një anëtar të vetin që të publikojë vendimet në vendin e caktuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara.

13.

Bordi i Këshillit të Mediave të Shkruara mund të vendosë për ndërprerjen e anëtarësisë të secilit anëtar, ashtu siç është parashikuar me Statut.

14.

Çdo vendim i marrë i dërgohet menjëherë medias në fjalë brenda tre ditëve të punës.

15.

Vendimet bëhen publike dhe u dërgohen mediave të shkruara, portaleve apo agjencive të lajmeve, anëtare të KMSHK për publikim jokomercial. Mediat e përfaqësuara në Këshillin e Mediave të Shkruara publikojnë vendimet e Këshillit të Mediave të Shkruara pa pagesë dhe në vendin e duhur.

16.

Shënimet mbahen për të gjitha rastet dhe publiku ka qasje në to. Materialet e mbajtura nga Këshilli i Mediave të Shkruara duhet të jenë në dispozicion për publikun, përveç nëse Ligji mbi Qasjen në Informata parashikon ndryshe.

17.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës merr në shqyrtim edhe ankesat kundër mediave të shkruara, portaleve apo agjencive të lajmeve – joanëtarë të KMSHK-së, ashtu siç është parashikuar në Statut. Lidhur me këto ankesa, KMSHK, zbaton procedurën si për anëtarët e vet. Nëse media – joanëtare, nuk dëshiron të bashkëpunojë me KMSHK-së, sipas procedurës së rregullt, KMSHK nxjerr opinion për ankesën në bazë të vlerësimeve që ai i siguron nga burimet tjera.

## Formular për ankesë

Për: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Prej: \_\_\_\_\_

Titulli: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Emri i mediumit ndaj të cilit ankoheni  
\_\_\_\_\_

Data e botimit të artikullit kundër të cilit është ankesa  
\_\_\_\_\_

Përshkrim i shkurtër i arsyeve për të cilat e parashtroni ankesën:  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Telefoni: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

**Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës**

## **Preambula**

- Ky Kod, i derivuar nga standardet ekzistuese ndërkombëtare të praktikës së gazetarisë, mëton të shërbejë si bazë për sistemin vetërregullues i cili do të konsiderohej profesionalisht dhe moralisht i obligueshëm për gazetarë, reporterë, redaktorë, pronarë dhe botues të gazetave, portaleve dhe agjencive të lajmeve.
- Gazetarët dhe redaktorët do të respektojnë parimet etike në vijim dhe do të mbrojnë integritetin profesional të gazetarisë.
- Redaktorët dhe botuesit do të sigurojnë që i mbarë stafi relevant punues është i informuar për këtë Kod. Tutje, ata do të sigurojnë respektimin e të gjitha dispozitave të këtij Kodi.

## **I. Dispozitat e përgjithshme**

1. Është detyrë e gazetarëve dhe e botuesve të respektojnë të drejtën e qytetarëve për informim me kohë dhe në plotëni. Gazetarët dhe botuesit do të mbrojnë parimet e lirisë së informimit, të drejtën në komentim të drejtë dhe në gazetari kritike.
2. Shtypi dhe portalet në Kosovë do të respektojnë standardet ndërkombëtare të mirësjelljes dhe të llojllojshmërisë etnike, kulturore dhe fetare.
3. Gazetarët dhe redaktorët nuk do të inkurajojnë, qëllimisht apo tërthorazi, diskriminimin dhe jotolerancën.
4. Gazetarët nuk do të veprojnë si përfaqësues të opinionit publik. Mediat nuk mund t'i zëvendësojnë funksionet specifike të autoriteteve apo institucioneve publike.
5. Vëzhgimi kritik i implementimit të pushtetit politik dhe ekonomik do të jetë ndër obligimet qenësore të shtypit dhe portaleve.

6. Organizatat mediale/të lajmeve do të dëshmojnë transparencë në çështjet e pronësisë dhe të menaxhimit të mediave, duke u mundësuar kështu qytetarëve qartësi rreth identitetit të pronarëve dhe të sasisë së interesit të tyre ekonomik në media.

## **II. Raportimi i së vërtetës**

1. Gjatë punës së tyre, gazetarët dhe redaktorët do të sigurojnë respekt për të vërtetën faktike dhe për të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën.

2. Gazetarët dhe redaktorët, në parim, duhet të mbështeten në burime të identifikueshme të informacioneve.

3. Gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve dhe publikimet e tyre janë të obliguara të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse kjo është kërkuar paraprakisht apo jo.

4. Duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet lajmeve dhe opinionëve. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionet bartin mendime, ide, besime apo gjykime vlerësuese nga ana e botuesve, gazetarëve dhe redaktorëve.

5. Gazetarët dhe publikimet e tyre kanë obligim profesional që me kohë ta korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar për të cilin vërtetohet të jetë i pasaktë.

6. Fotografitë dhe dokumentet nuk guxojnë të falsifikohen dhe/apo të përdoren në mënyrë të gabueshme.

7. Gazetari nuk guxon të bëjë plagjiat dhe duhet të theksojë burimin e informatës që është publikuar diku tjetër.

## **III. Nxitja dhe gjuha e urrejtjes**

1. Shtypi, portalet dhe agjencitë e lajmeve nuk do të nxisin veprime kriminale apo të dhunshme, pavarësisht nga situata apo rrethana.



2. Shtypi, portalet dhe agjencitë e lajmeve do të bëjnë të gjitha që munden për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi përmes:

a. Trajtimin me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore;

b. Përdorimit të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore.

3. Referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet.

#### **IV. E drejta për t'u përgjigjur**

1. Është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve e agjencive të lajmeve që të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë.

2. E drejta për t'u përgjigjur do t'u mundësohet personave përkatës nëse botimi në fjalë përcakton që duhet të ndërmerret një hap të tillë për qëllime të korrektësisë dhe paanshmërisë. Duhet të ekzistojë mundësi për publikim të menjëhershëm të reagimit/përgjigjes në median e njëjtë.

3. Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kontroverze, gazetatat, portalet dhe agjencitë e lajmeve do të përpiqen t'i dëgjojnë dhe t'i përfaqësojnë të gjitha palët në kontest. Nëse njëra palë brenda kontroversës refuzon të jetë në dispozicion për gazetarin, publikimi do të duhej ta theksojë këtë refuzim gjatë raportimit të vet.

#### **V. Personat e akuzuar për vepra penale**

1. Gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve nuk do ta trajtojnë asnjë individ si fajtor, para se një vendim i tillë të konfirmohet nga gjykata.

2. Gazetarët dhe redaktorët janë të obliguar të mos prejudikojnë fajësinë e një personi të akuzuar.

## **VI. Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve**

1. Gazetarët nuk do të duhej të intervistojnë apo të fotografojnë fëmijë nën moshën 18 vjeçare rreth çështjeve të cilat bëjnë fjalë për familjen e tyre, pa pëlqimin e prindit apo të ndonjë të rrituri i cili është përgjegjës për fëmijën.

2. Gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve në asnjë mënyrë nuk do të identifikojnë fëmijët nën moshën 18 vjeçare të cilët janë të përzier në vepra penale, qoftë si dëshmitarë, apo të pandehur.

3. Trajtimi i rrëfimeve mbi tragjeditë personale duhet të zhvillohet me kujdes, ndërkohë që ndaj individëve të prekur me tragjedi duhet pasur qasje mirëkuptimi dhe diskrecioni.

## **VII. Privatësia**

1. Gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve do t'u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përderisa ndërhyrje apo kërkime të tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik.

## **VIII. Korrupsioni dhe mitoja**

1. Gazetarët nuk do të pranojnë poste, mito apo cytje të tjera të cilat shkaktojnë konflikte interesi me profesionin e tyre, dhe të cilat komprometojnë kredibilitetin e tyre moral dhe profesional.

2. Gazetarët dhe redaktorët nuk do të pranojnë akte specifike të zemërgjerësisë të cilat do të mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre profesionale.

## **IX. Të drejtat e autorëve**

---

1. Botuesit, redaktorët dhe gazetarët në asnjë situatë nuk do të insistojnë në pronësi mbi lajmin.
2. Publikimet do të mund të përdoren arsyeshëm, dhe me citate të kufizuara, material nga publikime të tjera apo nga pronarë të së drejtës autoriale, pa leje të shprehur të tyre për ta bërë këtë. Megjithatë, botimi i materialit komplet do të duhej të ishte i mundur vetëm pas lejitimit paraprak, të dhënë nga mbajtësi i të drejtës autoriale.

## **X. Reklamat dhe sponsorimi**

1. Reklamimi komercial e politik, si dhe materiali sponsorues përfshirë këtu edhe artikuj apo shtojca, duhet të jetë qartë i dallueshëm nga përmbajtja editoriale dhe të identifikohet qartë se çfarë është.
2. Materiali i sponsoruar do të tregojë qartë burimin e sponsorimit.